

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **POSTA E KOSOVËS SH.A**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **vetak-26-1925-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Komtel Project Engineering SH.P.K.
NUI	811250836
Adresa	Agim Ramadani 34/7
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	-10000
Numri Telefonit	+383 49 702 470
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Ukë Gashi
Adresa elektronike	tndinfo@komtelpe.com
Data e parashtrimit të ankesës	20.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a

Më 13.04.2026, Posta e Kosovës Sh.A., në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar në platformën elektronike të prokurimit Njoftimin për Kontratë për aktivitetin “Zhvillimi dhe implementimi i sistemit qendror të Postës së Kosovës sh.a”, me numër të aktivitetit vetak-26-1925-2-1-1 dhe numër të brendshëm PK-26-26-211.

? Afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë më 25.05.2026, ora 14:00, ndërsa procesverbali i hapjes së ofertave është publikuar në të njëjtën datë, në orën 14:20. Kontrata është paraparë të jepet sipas kriterit “Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm”, me gjithsej 100 pikë.

? Më 02.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, duke rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik “Cactus” Sh.A., me 81.77 pikë dhe ofertë prej EUR 118,000.00. Në të njëjtën datë, Komtel Project Engineering SH.P.K. ka pranuar letrën standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, me 76.17 pikë dhe ofertë prej EUR 93,456.00.

? Më 07.07.2026, Komtel Project Engineering SH.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe vlerësimit të ofertës së vet.

? Me vendim të datës 10.07.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pabazuar dhe e ka lënë në fuqi vendimin e kontestuar.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

Më 07.07.2026, Ankuesi ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues. Me vendimin e datës 10.07.2026, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur: nenin 6 të Ligjit për Prokurimin Publik, sepse parimi i ekonomikutit dhe efikasitetit kërkon që vlerësimi të prodhojë rezultatin e bazuar në kriteret e shpallura dhe jo në vlerësime të pakontrollueshme.

Neni 7, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurimin Publik kërkon trajtim të barabartë, jo-diskriminues dhe transparent. Ky standard zbatohet edhe në fazën e pikëzimit: të njëjtat elemente të shpallura duhet të përdoren për çdo tender dhe arsyetimi duhet të mundësojë verifikimin e mënyrës së zbatimit të tyre.

Neni 10, paragrafët 1, 2 dhe 8, i Ligjit për Prokurimin Publik kërkon ruajtjen e dokumentacionit të plotë të aktivitetit dhe i jep Organit Shqyrtues të Prokurimit qasje në të gjitha shënimet e nevojshme për shqyrtim.

Neni 59, paragrafët 1 dhe 2, kërkon vlerësim të përgjegjshëm dhe ndalon ndryshimin material të tenderit përmes sqarimeve.

Neni 60, paragrafi 2, i Ligjit për Prokurimin Publik e lidh dhënien e kontratës mbi bazën e tenderit ekonomikisht më të favorshëm vetëm me kriteret dhe peshat e përcaktuara në dosjen e tenderit. Neni 40, paragrafët 1, 2 dhe 4, i Rregullores për Prokurimin Publik e konkretizon këtë detyrim: tenderët vlerësohen sipas kriterëve të publikuara dhe Autoriteti Kontraktues nuk mund të shtojë, ndryshojë ose heqë kritere gjatë vlerësimit.

Neni 108/A, paragrafët 9 dhe 12, i Ligjit për Prokurimin Publik kërkon që refuzimi dhe vendimi për kërkesën për rishqyrtim të jenë të arsyetuara dhe të komunikohen me shkrim. Po ashtu, pika 9.12 e Udhëzuesit nr. 002/2024 kërkon që kriteret të jenë objektive, të qarta, të verifikueshme dhe të mos ndryshohen ose zëvendësohen pas publikimit të procedurës.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Standardi juridik i zbatueshëm

Kur kontrata jepet sipas kriterit të tenderit ekonomikisht më të favorshëm, nenet 52, paragrafët 2, 3 dhe 5, dhe 60, paragrafi 2, të Ligjit për Prokurimin Publik (“**LPP**”), si dhe nenet 27.7, 27.9 dhe 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024 (“**Rregullorja**”), kërkojnë që kriteret, peshat dhe mënyra e pikëzimit të jenë të parapërcaktuara dhe të njohura për tenderuesit. Gjatë vlerësimit, Autoriteti Kontraktues nuk mund të shtojë, ndryshojë ose heqë kërkesa apo kriteret.

Vlerësimi profesional dhe krahasues i ofertave lejohet, por vetëm brenda kriterëve të peshuara dhe të publikuara. Arsyetimi duhet të jetë konkret dhe i verifikueshëm, duke e lidhur vlerësimin me kriteret e publikuara dhe me përmbajtjen e ofertës së dorëzuar.

Faktorët e lidhur me Termat e Referencës mund të shërbejnë si shpjegim vetëm për atë sa tregojnë mënyrën e përmbushjes së kriterëve të shpallura; ata nuk mund të përdoren si kriteret ose nënkriteret të reja autonome.

Secili nga arsyetimet në vijim paraqitet vetëm në mbështetje të kundërshtimeve të njëjta ndaj pikëzimit, të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim të datës 07.07.2026.

Pretendimi i parë: Vlerësimi i metodologjisë së punës me 16/20 pikë

-

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm (*Procesverbal nga komisioni i vlerësimit për ofertën – Komtel Project Engineering*) pranon se oferta e Komtel përmban Agile/SCRUM, sprint-e, CI/CD, code review, TDD dhe plan dinamik, por e vlerëson me 16/20 me arsyetimin se nuk është mjaftueshëm e thelluar në governance, acceptance criteria, menaxhim të rrezikut, quality gates dhe mekanizma të kontrollit për secilën fazë. Kërkesa për rishqyrtim i ka identifikuar konkretisht këto pjesë të ofertës: rreziqet dhe masat zbutëse (faqe 25), aprovimet formale dhe pranimin fazor (faqe 18–20), si dhe strukturën e ekipit dhe raportimin (faqe 26).

Matrica e Aneksit 6 e përkufizon nivelin “Shumë i mirë” si metodologji të detajuar, të qartë dhe të avancuar, me interval 16–20 pikë. Vendimi i datës 10.07.2026 pranon praninë

e disa elementeve të menaxhimit të rrezikut, quality gates dhe strukturës së projektit, por e arsyeton mosdhënien e pikëve maksimale me mungesën e “thellësisë operative dhe matshmërisë” për një sistem qendror me procese postare dhe financiare, integritet të brendshme e të jashtme, migrim të të dhënave, testim, pranim fazor dhe kontroll të ndryshimeve. Këto rrethana mund të shërbejnë si kontekst i Termave të Referencës, por nuk mund të përdoren si nënkritere të pavarura të pikëzimit.

Komtel vlerëson se Autoriteti Kontraktues nuk ka dhënë arsyetim konkret dhe të verifikueshëm pse pjesët e identifikuara në ofertë nuk justifikojnë një vlerësim më të lartë brenda intervalit 16–20 pikë, rrjedhimisht padrejtësisht është penalizuar me minus 4 pikë të vlerësimit.

Pretendimi i dytë: Vlerësimi i sigurisë së sistemit me 7/8 pikë

-

Aneksi 6 kërkon të vlerësohen autentikimi dhe menaxhimi i sigurt i përdoruesve, enkriptimi dhe mbrojtja e kredencialeve, mbrojtja ndaj sulmeve web dhe gjurmueshmëria përmes audit trail, si dhe përputhshmëria me standarde sigurie. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm shënon se oferta e Komtel përfshin autentikim të fortë, MFA, Active Directory, RBAC, session timeout, enkriptim, mbrojtje ndaj sulmeve web dhe monitorim të ngjarjeve, por nuk identifikon mangësi konkrete që shpjegon diferencën nga rezultati maksimal prej 8 pikësh.

Në vendimin për rishqyrtim thuhet se disa elemente janë deklarative ose konceptuale dhe përmenden konfigurimet konkrete, procedurat e monitorimit, testimi i sigurisë, përgjegjësitë operative, reagimi ndaj incidenteve dhe matja e efektivitetit të kontrolleve.

Këto rrethana mund të përdoren vetëm në masën në të cilën Autoriteti Kontraktues shpjegon lidhjen e tyre me elementet e publikuara të Aneksit 6; ato nuk mund të funksionojnë si standarde të reja dhe autonome të pikëzimit. Përndryshe, operatori ekonomik nuk mund të verifikojë pse elementet e pranuar në ofertë nuk janë konsideruar të mjaftueshme për nivelin “i avancuar”.

Kërkohet rivlerësim me arsyetim përmbajtësor, konkret dhe të verifikueshëm, i cili e lidh përmbajtjen relevante të ofertës me elementet e shpallura dhe shpjegon pse rezultati është 7, e jo 8 pikë. Një arsyetim i tillë përmbush detyrimin sipas nenit 108/A, paragrafëve 9

dhe 12, të Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi i tretë: Vlerësimi i backup-it dhe rikuperimit me 5/6 pikë

-

Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm pranon se oferta përmban backup të plotë, ruajtje on-site/off-site, plan për rikuperim nga fatkeqësitë, RPO/RTO dhe testim periodik të rikuperimit, por e mban rezultatin 5/6 duke iu referuar retention-it, versionimit dhe procedurave të plota të rikthimit. Aneksi 6 kërkon në mënyrë të shprehur mënyrën dhe frekuencën e backup-it, lokacionin dhe mënyrën e ruajtjes, versionimin dhe testimin periodik të rikuperimit, si dhe planin e rikuperimit nga fatkeqësitë.

Për këtë nënkriter, analiza duhet të jetë edhe më e lidhur me tekstin e shpallur: Autoriteti Kontraktues duhet të krahasojë ofertën e dorëzuar me secilin nga katër grupet e elementeve të Aneksit 6 dhe të dokumentojë objektivisht arsyen e dallimit ndërmjet 5 dhe 6 pikëve. Versionimi është element i publikuar dhe mund të vlerësohet; retention-i, përgjegjësitë gjatë rikuperimit, skenarët e testeve dhe dokumentimi mund të merren parasysh vetëm për atë sa shpjegojnë përmbushjen ose mospërmbushjen e elementeve të shpallura, jo si nënkritere të reja të pavarura.

Komtel konteston pikëzimin dhe kërkon rivlerësim mbi bazën e ofertës teknike të dorëzuar dhe kriterëve të shpallura, përfshirë Aneksin 6. Rivlerësimi nuk duhet të shërbejë për pranimin e sqarimeve që do të ndryshonin materialisht ofertën, në kundërshtim me nenin 59, paragrafi 2, të LPP-së dhe nenin 40.4 të Rregullores.

Pretendimi i katërt: Vlerësimi i kohës së reagimit për incidente me 5/8 pikë

-

Aneksi 6 përcakton tri nivele incidenti dhe pragjet përkatëse: kritik nën 6 orë, i mesëm nën 24 orë dhe i ulët nën 72 orë. Rezultati maksimal prej 8 pikësh lidhet me “kohë reagimi të qarta dhe të favorshme për të tri nivelet e incidenteve”. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm shënon kohët “1.24.36 (orë)” dhe rezultatin unanim 5/8, por nuk e lidh

pikëzimin me secilin nivel të matricës.

Në vendimin e datës 10.07.2026, Autoriteti Kontraktues sqaron se ka vlerësuar nivelet P1–P4, shpejtësinë relative në krahasim me ofertat e tjera, mbulueshmërinë operative, procedurat e eskalimit, kapacitetin praktik të reagimit dhe qartësinë e marrëveshjeve të nivelit të shërbimit. Vetë krahasimi ndërmjet ofertave nuk kundërshtohet si i tillë; megjithatë, ai mund të bëhet vetëm në bazë të përshkruesve dhe niveleve të shpallura në Aneksin 6. Prandaj, nëse Autoriteti Kontraktues mbështetet në krahasimin relativ, duhet të shpjegojë se si, brenda parametrave të publikuar — qartësisë dhe favorshmërisë së kohëve për tri nivelet e incidenteve — oferta e Komtel çon në rezultatin 5/8. Faktorët e tjerë nuk mund të funksionojnë si nënkritere të reja autonome të pikëzimit.

Komtel kërkon që Autoriteti Kontraktues, gjatë rivlerësimit, të hartëzojë vetëm përmbajtjen e ofertës së dorëzuar me tri nivelet e shpallura dhe të shpjegojë mënyrën si ka arritur në rezultatin 5/8. Kjo e bën vlerësimin të verifikueshëm pa e ndryshuar ofertën ose nënkriterin pas hapjes së tenderëve.

Pretendimi i pestë: Vlerësimi i mënyrës dhe organizimit të mbështetjes me 2/3 pikë

-

Sipas Aneksit 6, niveli i avancuar me 3 pikë përkufizohet me tri elemente: “Remote, onsite dhe ekip i dedikuar”. Letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm shënon rezultatin 2/3, ndërsa kërkesa për rishqyrtim ka referuar se oferta e Komtel, në pjesën “Stafi Profesional” (faqe 26), parashihte ekip të dedikuar. Vendimi i datës 10.07.2026 arsyeton se ky element, i vetëm, nuk është i mjaftueshëm dhe përmend raportimin, eskalimin, mbulueshmërinë operative, dokumentimin e ndërhyrjeve, kanalet e komunikimit dhe ndarjen e përgjegjësisë.

Aneksi 6 përmban edhe dispozita të detyrueshme për dëshmi mbi mënyrën e ofrimit të shërbimit, kanalet e komunikimit dhe strukturën organizative, kur aplikohet. Për këtë arsye, ekzistenca e ekipit të dedikuar nuk e përcakton vetvetiu rezultatin 3/3. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues duhet të tregojë nëse oferta nuk e plotëson elementin remote, onsite ose ekipin e dedikuar, apo cilën dëshmi të kërkuar e konsideron të munguar dhe pse kjo mungesë e justifikon pikërisht rezultatin 2/3.

Një shpjegim i tillë është i nevojshëm që faktorët e përmendur në vendim të mbeten të lidhur me tekstin e shpallur të Aneksit 6 dhe të mos shndërrohen në kërkesa të reja.

Kërkohej rivlerësim dhe arsyetim në përputhje me matricën e publikuar, pa rezultat të paracaktuar.

Pretendimi i gjashtë: Ekonomiciteti, diferenca e çmimit dhe interesi material

Në kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi ka theksuar se oferta e tij është 93,456.00 euro me TVSH, ndërsa oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë është 118,000.00 euro me TVSH. Diferenca ndërmjet ofertave është 24,544.00 euro.

Diferenca e çmimit nuk paraqitet si bazë autonome për përzgjedhje automatike dhe as si zëvendësim i kriterëve cilësorë. Ajo, së bashku me mundësinë që rivlerësimi i pikëve të kontestuara të ndikojë në renditje, demonstroi interesin material të Ankuesit sipas nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.26, të LPP-së. Neni 6, paragrafi 1, i LPP-së mbetet relevant vetëm në masën që rivlerësimi të bëhet sipas kriterëve të shpallura.

Mjeti korrigjues i kërkuar mbetet rivlerësimi i ligjshëm, transparent dhe i arsyetuar i ofertave, pa rezultat të paracaktuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

- **Dëmtimi i imazhit dhe reputacionit të kompanisë**
- **Dëmtimi financiar në realizimin e supozuar të projektit në shumën e ofertës financiare**
- **Dëmtimi në mundësinë e realizimit të projektit dhe portfolios së kompanisë**

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.